

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vilat në Dhërmi dhe Palasë/ Gati kërkesa e dytë e SPAK për arrestimin e Ballukut
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/11/vilat-ne-dhermi-dhe-palase-gati-kerkesa-e-dyte-e-spak-per-arrestimin-e-ballukut/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHÀ


KAPUR NGA NE	11 shtator 2026, 14:44:35 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	11 shtator 2026, 14:42:52 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4a0e8155d73c29ca45118e34d1e04631bc29f5064cff7ebf288beef797422aca
TEKSTI	590d3a2f55170105a3f25f6c9e3e28a5ef4ecc7cae062fb69cd0bc877bec6cd5
PAMJA	9b4ffe0234e02790eeafa27d21cd24046fda0b78a6abe1499d93cdf967a35b14

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7f5375c0d8ab86015844bb14ff42ab1b8e4951935f5fe8c868b9ed303f097bc0
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	449e01d01289e86e32f44a76b2516514aa0ab1525100d1a30f454146706caeb7
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7f5375c0d8ab86015844bb14ff42ab1b8e4951935f5fe8c868b9ed303f097bc0>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > AKTUALITET

Vilat në Dhërmi dhe Palasë/ Gati kërkesa e dytë e SPAK për arrestimin e Ballukut

16:42 : 11/09/2026 në AKTUALITET, POLITIKE



SPAK pritet t'i drejtohet për herë të dytë Kuvendit për heqjen e imunitetit të Belinda Ballukut, duke e vendosur sërish Edi Ramën dhe shumicën socialiste përballë zgjedhjes nëse do t'i hapin rrugë drejtësisë apo do t'i mbeten mbrojtjes politike që i dhanë ish-zëvendëskryeminitres në kërkesën e parë.

Lapsi.al bën me dije se Prokuroria e Posaçme pritet të dorëzojë sot ose nesër në Kuvend kërkesën e dytë për imunitetin e Ballukut.

Kërkesa vjen në një moment kur pozita penale e ish-zëvendëskryeminitres është rënduar ndjeshëm. SPAK ka bashkuar në dosjen "Balluku" disa procedime penale, ndërsa numri i personave dhe kompanive të akuzuara është rritur ndjeshëm. Mes tyre janë ish-vartës të Ballukut dhe biznesmenë që dyshohet se përfituan tendera publikë në këmbim të rryshfeteve dhe favoreve.

Balluku akuzohet për "Shkelje të barazisë në tendera", të kryer në bashkëpunim, "Fshehje të pasurisë", "Korrupsion pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë" dhe "Pastrim parash", këto të fundit më shumë se një herë.

Lexo edhe:

Dalin PAMJET/ Ky është hoteli në Santorini që frymëzoi vilën e Belinda Ballukut në Palasë

Bardhi: SPAK të rikthejë kërkesën në Kuvend për imunitetin e Ballukut

Hetimi nisi me tenderin e Tunelit të Llogarasë, por më pas u zgjerua në një seri procedurash të mëdha infrastrukturore. SPAK e akuzon Ballukun për shkelje të barazisë në tendera në tërë raste, ku përfshihen Tuneli i Llogarasë, punimet në Sheshin Shqiponja dhe disa lote të Unazës së Madhe të Tiranës.

Më tej dosja u rëndua për gjetje që lidhen me pasuritë që SPAK dyshon se Balluku i përfitoi si rryshfet.

Në qershor, Prokuroria njoftoi se ish-zëvendëskryeministria dyshohet se përfitoi një vilë me vlerë 145 mijë euro në Dhërmi nga shoqëria "Eurocol", në këmbim të favorizimit të kompanisë në një tender gjatë kohës kur Balluku ishte në krye të Albcontrol. Sipas SPAK,

TË GJITHA



Vilat në Dhërmi dhe Palasë/ Gati kërkesa e dytë e SPAK për arrestimin e Ballukut

16:42 : 11/09/2026



Nga president në kandidat për kryeministër, Vuçiç zbulon kur do të japë dorëheqjen

16:31 : 11/09/2026



Rifillon seanca konstituive në Kuvendin e Kosovës, opozita bojkoton

16:21 : 11/09/2026



Bota kërcënohet nga terrorizmi/ Kreu i Inteligjencës britanike: Mund të goditemi si 11 shtatori

16:11 : 11/09/2026



Incident në avionin e Easyjet/ Aeroporti i Malpensas në Milano mbyllet për një orë

16:04 : 11/09/2026



Plagoset me thikë 25-vjeçari në Shkozë, arrestohet autori

15:50 : 11/09/2026



Microsoft lançon një strukturë sigurie për inteligjencën artificiale për të rinjtë

15:43 : 11/09/2026

prona u fsheh përmes një skeme pastrimi parash ku u përfshi edhe ish-futbollisti Igli Tare.

Më pas hetuesit sekuestruan edhe një vilë të dytë, këtë herë në kompleksin “Green Coast” në Palasë, e regjistruar formalisht në emër të Tares, por që SPAK pretendon se ishte në “pronësi indirekte” të Ballukut.

Sipas hetimit, punimet luksoze të vilës dhe pishinës, me një vlerë që sipas preventivave varionte nga rreth 289 mijë deri në 411 mijë euro, u paguan nga “Alko Impex General Construction” e biznesmenit Arbër Abazi. Në të njëjtën periudhë, kjo kompani përfitoi së bashku me “2T” tenderin prej 2.2 miliardë lekësh për Lotin 7 të Unazës së Madhe.

SPAK pretendon se tenderi u manipulua nën udhëzimet e Ballukut dhe se pagesa e punimeve të vilës ishte shpërblimi për favorizimin e kompanisë. Mes provave janë komunikimet e sekuestruara, dokumentet financiare dhe emaillet e arkitektëve, përfshirë komunikime të drejtpërdrejta me Ballukun për mënyrën se si duhej të projektohej vila.

Në pranverë, shumica socialiste e drejtuar nga Edi Rama e bllokoi kërkesën e SPAK për t’i hapur rrugë masës së sigurisë ndaj Ballukut. Kundër kërkesës votuan 82 deputetë, ndërsa Fatmir Xhafaj, Elisa Spiropali dhe Blendi Gonxhe nuk morën pjesë në votim.

Vendimi shkaktoi reagime të forta ndërkombëtare. Ambasadat e Gjermanisë, Britanisë dhe Holandës, si dhe Komisioni Europian, kërkuan që SPAK të jetë në gjendje të hetojë korrupsionin e nivelit të lartë pa pengesa politike, duke e lidhur drejtpërdrejt këtë standard me procesin e integritetit evropian.

Rama reagoi atëherë ashpër ndaj presionit ndërkombëtar, duke deklaruar se SPAK nuk ka “karta bianka” për arrestimin e politikanëve dhe duke mbrojtur vendimin e shumicës së tij.

SPAK pritet të trokasë për herë të dytë në derën e parlamentit, ndërsa mbi tryezë nuk është më vetëm dosja fillestare e tenderave, por një hetim më i gjerë, me akuza për korrupsion, pastrim parash, fshehje pasurie dhe dy vila që Prokuroria pretendon se janë produkte të përfitimeve korruptive.

Etiketa: belinda balluku spak

Lajme të lidhura



Dalin PAMJET/ Ky është hoteli në Santorini që frymëzoi vilën e Belinda Ballukut në Palasë

14:52 : 11/09/2026



Bardhi: SPAK të rikthejë kërkesën në Kuvend për imunitetin e Ballukut

14:13 : 11/09/2026



SPAK merr nën hetim deputetin e PD, Luan Baçi

11:30 : 11/09/2026



Ilir Beqaj paraqitet në SPAK, shoqërohet nga efektiv i policisë

11:07 : 11/09/2026



VIDEO/ Deputeti demokrat Luan Baçi paraqitet në SPAK

10:25 : 11/09/2026



Një vilë në këmbim të tenderit/ Si e fshehu Balluku pronën e dytë në Palasë

08:10 : 11/09/2026

BOLD NEWS

RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto:

NA NDIQ

f i g y

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.